

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kuvendi miratoi formulën e re të pagave, magjistratët nuk tërhiqen: Do e çojmë në Gjykatën Kushtetuese
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/kuvendi-miratoi-formulen-e-re-te-pagave-magjistratet-nuk-ter-hiqen-do--i514841
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHË


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 13:40:18 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 13:28:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	75d226cb8fa16a995de8211bea001c0b2fa053005c39727e77163e100822d1e0
TEKSTI	e90e9f1251cb255052a305679f594290696e4fe1b7d1aca7197cf7a7e745c35f
PAMJA	72b700c08097d32cd1706b7f317cef34a54ae97522b4684b076fd14a51d4148e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	59c08e9949ae62d1bb1dfcbae64284bd6e9493b11d55920aa5041c620386c5a9
E MËPARSHMJA	cceed5eacdde86954fc8b92bc09375589d065b1ce6b87394d1134574a2b55c34
RRËNJA MERKLE	565145c81569d96b39079f1db9ed9e378c0d0ec132a26687d139f465bf7be21b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/59c08e9949ae62d1bb1dfcbae64284bd6e9493b11d55920aa5041c620386c5a9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

3 ORE ME PARE

Pas vendimit të Hagës, Prishtina ngrihet në protestë/ Policia kërkon dokumente identifikimi për pjesëmarrësit, protestuesit kundërshtojnë

6 ORE ME PARE

"Protestat ndaj qeverisë janë demokraci"/ Rama: Gjykata Kushtetuese nuk i dikton Kuvendit si të votojë, të kërkojë rritje sa herë rriten pagat e të tjerëve është lajthitje

19 ORE ME PARE

110 ditë qëndresë/ Pas protestës para Kuvendit qytetarët mbledhen sërisht në Bulevard: Arrestoni Ramën!

1 DITË ME PARE

Vendimi i Hagës nxiti protesta dhe reagime në Kosovë/ PDK mbledh Kryesinë, familjarët: Gjykatë kriminale, presim pafajësi në Apel

Aktualitet

Kuvendi miratoi formulën e re të pagave, magjistratët nuk tërhiqen: Do e çojmë në Gjykatën Kushtetuese

Katër organizata shprehin bindjen e plotë në integritetin e procesit kushtetues dhe besimin se Gjykata Kushtetuese do të rivendosë standardet kushtetuese të cenuara. Ata theksojnë se kjo çështje nuk ka të bëjë me interesa financiare, siç është tentuar, në mënyrë të shtrembëruar, t'i paraqitet opinionit publik gjatë gjithë këtij procesi.



18 Shtator 2026, 15:28
Nga E. D



foto ilustruese

TIRANË- Shoqatat e gjyqtarëve dhe prokurorëve kanë kundërshtuar formulën e re të pagave të magjistratëve, të miratuar nga Kuvendi. Me anë të një deklaratë të përbashkët, Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, Shoqata e Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë dhe Forumi i Grave Gjyqtare njoftojnë se do t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar pezullimin dhe shfuqizimin e ligjit.

Katër organizata shprehin bindjen e plotë në integritetin e procesit kushtetues dhe besimin se Gjykata Kushtetuese do të rivendosë standardet kushtetuese të cenuara. Ata theksojnë se kjo çështje nuk ka të bëjë me interesa financiare, siç është tentuar, në mënyrë të shtrembëruar, t'i paraqitet opinionit publik gjatë gjithë këtij procesi. Sipas organizatave, çështja lidhet me respektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, garantimin e pavarësisë së organeve të drejtësisë dhe mbrojtjen e themeleve të shtetit të së drejtës.

Deklarata:

editoriale

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet
kërkuar tek revolta e
protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika

Plaçkaxhiu

Në vëmendje

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 10:36

"O Hashim ti ku je, UÇK-në këtu e ke"/ Shkuan në Hagë në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së, 50 veteranët mbërrijnë në Portin e Durrësit (VIDEO)

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 09:22

Analiza: Çfarë mund të ndodhë me shtatë figurat e UÇK-së që u përmendën në aktgjykimin e 16 shtatorit?

unioni i Gjyqtareve të Shqipërisë, Shoqata Kombëtare e Gjyqtareve të Republikës së Shqipërisë, Shoqata e Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë dhe Forumi i Grave Gjyqtare të Shqipërisë shprehin vendosmërinë e tyre për të vijuar ndjekjen e procesit kushtetues lidhur me pagat e magistratëve.

Me keqardhje kemi ndjekur procedurën parlamentare për miratimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Që në fillim, kjo procedurë është karakterizuar, në vlerësimin tonë, nga shkelje të kërkesave kushtetuese, duke nisur nga miratimi i projektligjit përtej afatit kushtetues, mungesa e një analize financiare nga Këshilli i Ministrave, mungesa e konsultimit efektiv dhe dëgjimi tërësisht formal i grupeve të interesit dhe, në fund, hyrja e menjëhershme në fuqi e ligjit.

Shoqatat tona mbeten të palëkundura në qëndrimin e tyre për rivendosjen e të drejtave kushtetuese të magistratëve, të cilat janë cenuar haptazi nga ligji i miratuar në orët e mesnatës. Në këtë kuadër, informojmë opinionin publik se, me të njëjtën urgjencë me të cilën ky projektligj u shqyrtua, u miratua dhe u dekretua, do t'i drejtohem Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar pezullimin e zbatimit të ligjit, shfuqizimin e tij si të papajtueshëm me Kushtetutën, si dhe shqyrtimin e çështjes me përparësi.

Kjo kërkesë bëhet e domosdoshme pasi, përmes këtij ligji, cenohet jo vetëm statusi financiar i magistratëve, i cili është i lidhur ngushtësisht me garantimin e pavarësisë së tyre, por edhe vetë themelet e shtetit të së drejtës, për shkak të mosrespektimit të hapur të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese.

Shoqatat tona shprehin bindjen e plotë në integritetin e procesit kushtetues dhe besimin se Gjykata Kushtetuese do të rivendosë standardet kushtetuese të cenuara. Kemi besimin e plotë se do të jetë pikërisht procesi kushtetues ai që do të sqarojë çështjet e ngritura dhe do të hedhë poshtë përpjekjet për të diskredituar magistratët dhe kërkesat e tyre legjitime.

Theksojmë edhe një herë se kjo çështje nuk ka të bëjë me interesa financiare, siç është tentuar, në mënyrë të shtrembëruar, t'i paraqitet opinionit publik gjatë gjithë këtij procesi. Ajo lidhet me respektimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, garantimin e pavarësisë së organeve të drejtësisë dhe mbrojtjen e themeleve të shtetit të së drejtës. Për mbrojtjen e këtyre parimeve dhe vlerave kushtetuese, shoqatat tona mbeten të palëkundura dhe do të përdorin çdo mjet ligjor që Kushtetuta dhe ligji u vënë në dispozicion.

Ngërçi me pagat në gjyqësor

Kriza e pagave në sistemin e drejtësisë u përshkallëzua pasi Kuvendi nuk miratoi deri më 31 korrik formulën e re të pagave, në përputhje me kërkesën e Gjykatës Kushtetuese. Pas skadimit të afatit, Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) vendosën që, nga 1 gushti, paga referuese të llogaritej mbi bazën e 222 mijë e 425 lekëve, duke i shtuar edhe 14 mijë lekë për kualifikimin. Megjithatë, Ministria e Financave nuk i ekzekutoi listëpagesat sipas kësaj formule, me argumentin se përcaktimi i pagave të magistratëve dhe administratës së drejtësisë është kompetencë e Kuvendit./Dosja.al

- shoqatat e gjyqtarëve
- gjykata kushtetuese

Sondazh

Poll

AKTUALITET 18 SHTATOR 2026, 07:21

Gati gjysma e shqiptarëve kanë vështirësi të mbyllin muajin, e dyta në Europë

më të klikuarat

Hetimet për nënshkrimet e partisë/ Parlamentit European i heq imunitetin eurodeputetes greke Afroditi Latinopoulou

Shkatërrohet organizata shqiptare që frymëzoi serialin e famshëm ‘Marbella’/ Kapen 2.7 ton kokainë, sekuestrohen dy armë zjarri dhe 29 mjete luksoze, 15 persona të arrestuar (VIDEO)

Gjykata Speciale e dënoi me 25 vite burg/ Reagon Thaçi: Mirënjohje popullit të Kosovës për mbështetjen, do ta apelojmë vendimin e Hagës

“Do martoheshin”/ 34-vjeçarja përgënjeshtroi Zegjine Çaushin dhe sqaron foton e publikuar: Unë me atë, kurrën e kurrës! Me kërcënoi

insights

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Bledian Koka
Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?

Moti

Powered by tomorrow.

Aktualitet

18 Shtator 2026, 14:50

Ndryshime në Autoritetin e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar/ Largohet Altin Jani, zëvendësohet nga Ermal Jauri

Foto ilustruese TIRANA- Ermal Jauri është emëruar drejtor i ri i Përgjithshëm i Autoritetit Kombëtar të Sigurisë...

Aksident rrugor në Elbasan, plagoset një grua dhe një fëmijë

Aktualitet

18 Shtator 2026, 14:39

U votua gjatë natës në Kuvend, botohet në Fletoren Zyrtare formula e pagave të magistratëve

Aktualitet

18 Shtator 2026, 14:31

Largoi 950 mijë € verë nga vila e Ergys Agasit, Gjykata e Tiranës lë në burg kushëririn e tij, Eno Agasin

Aktualitet

18 Shtator 2026, 14:50

Aksident në aksin Elbasan-Librazhd/ Përplasen dy automjete, nuk ka të plagosur

Aktualitet

18 Shtator 2026, 13:43

Aktualitet

18 Shtator 2026, 13:18

I riu rrëshqet aksidentalisht në një lokal dhe pëson

dëmtime në kokë, niset me helikopter drejt Traumës

Foto ilustruese SHKODRA- Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në Shkodër, ku një 25-vjeçar është dërguar ...

Protesta në Prishtinë/ Djali i Jakup Krasniqit: Nuk duhet të dorëzohemi, ajo që ndodhi në Hagë prek sakrificën e çdo dëshmori (VIDEO)

Aktualitet

18 Shtator 2020, 13:09

Protesta në Prishtinë/ Djali i Kadri Veselit: Nuk e kemi humbur besimin te bota perëndimore dhe drejtësia e tyre (VIDEO)

Aktualitet

18 Shtator 2020, 13:02

"Më ka thyer krahun dhe ka abuzuar"/ Ish gruaja e dajës së Zegjine Çaushtit: Nuk më ka lënë të takoj djalin prej dy vitesh...

Aktualitet


18 Shtator 2020, 12:42

SKANDALI me Postën e Durrësit/ Ish-drejtoresha vodhi 700 mijë euro, bashkëshorti i saj emërohet përgjegjës për Evadimin e Mbetjeve


Aktualitet

18 Shtator 2020, 12:28

MË SHUMË



Rama takime me furnitorë: Po fitoni më shumë se ç'e mban zakoni i mirë



Rama takime me furnitorë: Po fitoni më shumë se ç'e mban zakoni i mirë

Djali i Jakup Krasniqit: Nuk dorëzohemi, ajo që ndodhi në Hagë prek sakrificën e çdo dëshmori

Djali i Kadri Veselit: Nuk e kemi humbur besimin te bota perëndimore dhe drejtësia e tyre

Përfshihet nga flakët një automjet në një parkim nëntokësor në Fier, policia nis hetimet

Rama takime me furnitorë: Po fitoni më shumë se ç'e mban zakoni i mirë

Shiko video te tjera



Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vërtetë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [\[email protected\]](#)



[KONTAKT](#) [PRIVACY POLICY](#) [COOKIES](#)

MEMBERSHIP INFLA  Mediadesk

AKTUALITET

POLITIKE

EKONOMI

BOTA

SPORT

ART&ARGËTIM

INSIGHTS

EDITORIAL

Drejtör: Enton Abilekaj

Kryeredaktor: Izmir Akulli

Gazetarë:

Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.